



European Fact-Checking
Standards Network

EFCSN

Rrjeti Evropian i Standardeve të Verifikimit të Fakteve

**Kodi Evropian i Standardeve për
Organizatat e Pavarura të Verifikimit të Fakteve**

Gusht 2022

EFCSN mbështetet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit të punës 2020 për financimin e projekteve pilot dhe masave përgatitore në fushën e “Rrjeteve të Komunikimit, Përmbytjes dhe Teknologjisë”. Numri i marrëveshjes: LC-01740478

INDEKSI

HYRJE	4
LEGJITIMITETI I KODIT	4
STANDARDET E KODIT	5
KAPITULLI 1: KODI I STANDARDEVE.....	5
Neni 1: Sistemi i Pajtueshmërisë.....	5
KAPITULLI 2: METODOLOGJIA	5
Neni 2: Metodologjia	5
KAPITULLI 3: STANDARDET ETIKE	7
Neni 3: Standardet etike	7
Neni 3. 1: Pavarësia dhe paanshmëria.....	7
Neni 3. 2: Privatësia dhe Siguria.....	8
Neni 3. 3: Korrigjime të ndershme.....	8
KAPITULLI 4: TRANSPARENCA.....	9
Neni 4: Transparenca	9
Neni 4.1: Transparenca organizative.....	9
KAPITULLI 5: AKSESI DHE RINOVIMI	12
Neni 5: Aksesit	12
Neni 5. 1: Procedura e vlerësimit	12
Neni 5. 2: Kriteret.....	13
Neni 5. 3: Formulari i aplikimit	14
Neni 5. 4: Vlerësuesit	14
Neni 5. 5: Rishqyrtimi.....	14
Neni 5. 6: Rinovimi.....	14
KAPITULLI 6: PAJTUESHMËRIA DHE ZBATIMI	15
Neni 6: Pajtueshmëria	15
Neni 6.1: Shqyrtuesi i ankesave	15
Neni 6. 2: Procedura e pajtueshmërisë	16
Neni 6. 3: Sanksionet	16
KAPITULLI 7: EVOLUIMI DHE NDRYSHIMET	17
Neni 7: Evoluimi i Kodit.....	17
Neni 7. 1: Procedura.....	17
ANEKSET	19
Aneksi 1. Anëtarët e Grupit të Gjerë.....	19
Aneksi 2. Anëtarët e Komitetit të Punës	20
Aneksi 3. Modeli i Nenit 3. 1. I.....	20

Aneksi 4. Formulari Model sipas Nenit 4.1.A	21
Aneksi 5. Formulari Model i Nenit 4. 1. B	21
Aneksi 6. Formulari Model sipas Nenit 4. 1. C.....	22
Aneksi 7. Formulari Model sipas Nenit 4. 2. A	22
Aneksi 8. Formulari Model sipas Nenit 4. 2. B.....	22
Aneksi 9. Formulari Model sipas Nenit 4.2. D	23
Aneksi 10. Formulari Model sipas Nenit 5. 4	23
Aneksi 11. Formulari Model sipas Nenit 6	25

HYRJE

Kodi Evropian i Standardeve për Organizatat e Pavarura të Verifikimit të Fakteve është një grup kriteresh të krijuara për t'u siguruar që organizatat që verifikojnë faktet, keqinformimet dhe dezinformimet, t'u përmbahen standardeve më të larta të metodologjisë, të etikës dhe të transparencës në mënyrë që t'i shërbejnë më së miri interesit publik. Në momentin që vërtetohet respektimi nga ana e një organizate i standardeve profesionale të përcaktuara në këtë Kod, ajo organizatë bëhet anëtare e [Rrjetit Evropian të Standardeve për Verifikimin e Fakteve \(EFCSN\)](#).

Kodi Evropian i Standardeve dhe EFCSN janë të hapura për organizatat e dedikuara ndaj **verifikimit të fakteve**, përkufizuar si përdorimi i një metode të bazuar në prova për të verifikuar saktësinë e pretendimeve të bëra publikisht. Për të aplikuar, organizatat duhet të jenë të fokusuar në mënyrë thelbësore dhe të demonstrueshme në një vend që është anëtar i [Këshillit të Evropës](#), ose në Kosovë ose Bjellorusi.

Anëtarësimi në EFCSN nënkupton angazhimin rigoroz të një organizate për të ofruar informacion të saktë në mënyrë etike dhe transparente, në mënyrë të paanshme dhe pa paragjykime. Organizatat anëtare duhet të fokusohen në çështje me interes për publikun dhe të kenë një historik të dëshmuar të përsosmërisë, integritetit dhe llogaridhënies.

LEGJITIMITETI I KODIT

Kodi Evropian i Standardeve është rezultat i një dialogu rreth standardeve thelbësore dhe praktikave më të mira të komunitetit të verifikimit të fakteve në rajon. Në thelb të këtij procesi ka qenë një Grup i Gjerë prej më shumë se 40 organizatash fakt-verifikuese (shih Aneksin 1); opinionet dhe idetë e tyre rreth asaj se çfarë duhet të përmbajë ky kod u mbledhën në një konsultim të hapur dhe më pas u përkthyen në draftet e hershme të Kodit nga një Komitet Pune (shih Shtojcën 2) i zgjedhur nga Grupi i Gjerë për të drejtuar procesin. Ky Grup i Gjerë ofroi disa ndryshime në draftin përfundimtar dhe në fund e miratoi Kodin Evropian të Standardeve me një shumicë të cilësuar prej $\frac{3}{4}$ në verën e vitit 2022.

Hartimi i këtij kodi përfitoi edhe nga njohuritë e studiuesve dhe akademikëve, shoqatave të medias, grupeve të shoqërisë civile, platformave të mediave sociale dhe palëve të tjera të interesuara që u ftuan të merrnin pjesë në Konsultimin e Hapur.

STANDARDET E KODIT

Kodi Evropian i Standardeve parashtron tre kategori kryesore standardesh: Standardet Metodologjike, Standardet Etike dhe Standardet e Transparencës. Në Kod përcaktohet gjithashtu edhe mënyra se si do të vlerësohen dhe si do të zbatohen këto standarde, si dhe procesi i ndryshimeve që mund t'i bëhen Kodit në të ardhmen.

Për standardet metodologjike, Kodi përshkruan hapat që anëtarët e verifikuar duhet të ndërmarrin për t'u siguruar që hetimet e tyre të jenë transparente, profesionale dhe të përkushtuara ndaj niveleve më të larta të saktësisë. Në kapitullin mbi etikën parashikohen me detaje standardet që duhet të respektohen nga anëtarët e verifikuar për të mbrojtur paanshmërinë e tyre, për t'i trajtuar korrigjimet në mënyrë transparente dhe për të ruajtur sigurinë dhe privatësinë e subjekteve. Në fund, Standardet e Transparencës mbulojnë informacionin që anëtarët duhet të ndajnë në lidhje me strukturën e tyre organizative, burimet e financimit dhe marrëveshjet e partneritetit në mënyrë që të nxisin besim dhe të sigurojnë pavarësinë e tyre editoriale.

Kodi Evropian i Standardeve synon të jetë një nxitje për anëtarët e verifikuar që ata të vazhdojnë të përmirësohen. Për ta arritur këtë, Kodi identifikon dhe inkurajon edhe të tjera praktika të mira që nuk janë të detyrueshme për anëtarësim, por që do të vlerësohen nga vlerësuesit gjatë procesit të aplikimit. EFCSN do t'i mbështesë organizatat me trajnime dhe me forma të tjera ndihme, në mënyrë që ato të arrijnë standardet e praktikave më të mira.

KAPITULLI 1: KODI I STANDARDEVE

Neni 1: Sistemi i Pajtueshmërisë

- A. Për të qenë një anëtar i verifikuar i EFCSN, veprimet e verifikimit të fakteve duhet të jenë plotësisht në përputhje me të gjitha standardet në këtë Kod.
- B. Pas miratimit si anëtar i verifikuar, çdo operacion duhet të bëjë publikisht të ditur në faqen e vet të internetit se është anëtar i verifikuar i EFCSN dhe të vendosë aty linkun që të çon tek aplikimi i tyre i miratuar.
- C. Operacionet që e marrin këtë cilësim (distinktiv) do të renditen edhe në faqen e internetit të EFCSN.
- D. Operacionet që shkojnë edhe më tej në përmbushjen e praktikave më të mira të përshkuara në këtë Kod inkurajohen që ta bëjnë të ditur këtë në faqet e tyre të internetit.
- E. Organizatat mëmë duhet të ndjekin në përgjithësi frymën dhe standardet etike të këtij Kodi.

KAPITULLI 2: METODOLOGJIA

Neni 2: Metodologjia

Anëtarët e verifikuar të Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve (EFCSN) duhet të përqendrohen në tema me interes për publikun dhe të ndjekin një metodologji të qartë

dhe transparente, ku shpjegohet pse dhe si zgjidhen dhe hetohen çështje të caktuara. Për të siguruar nivelet më të larta të saktësisë, gjetjet duhet të mbështeten dhe të verifikohen nga burime me cilësi të lartë dhe të paraqiten me një gjuhë të saktë dhe faktike.

Për t'u njohur si anëtar i verifikuar i Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve (EFCSN), operacionet duhet:

- A. Të postojnë dhe ta bëjnë lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit një shpjegim mbi procesin që ndjekin për përzgjedhjen, kërkimin dhe realizimin e hetimeve, duke përfshirë edhe një përkufizim të çdo sistemi vlerësimi që ata përdorin.
- B. Të vlerësojnë bazën e provave të gjetura, duke përdorur të njëjtat standarde që përdorin edhe për provat mbi pretendimet ekuivalente, pavarësisht se kush ka dalë me ato pretendime.
- C. Të fokusohen kryesisht në tema që janë me interes për publikun, të përkufizuara në këtë kod si çështje që kanë të bëjnë me mirëqenien e shoqërisë ose të individëve, dhe të jenë të gatshme të shpjegojnë, nëse kërkohet nga një vlerësues, se si përputhen hetime të ndryshme me këtë përkufizim.
- D. Të vënë në dispozicion dhe të bëjnë lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit një kanal përmes të cilit publiku të mund të paraqesë pretendime të mundshme për verifikim dhe t'i inkurajojnë përdoruesit që të dërgojnë pretendime për verifikim, duke ua bërë të qartë se ajo çka mund të presin si përgjigje legjitime është e verifikuar në bazë faktesh, duke sqaruar gjithashtu edhe çfarë nuk mund të verifikohet sa u përket fakteve.
- E. Të identifikojnë dhe të përfshijnë në publikimet e tyre, aty ku është e mundur, aksesin në të gjitha provat ose informacionet e tjera që i nevojiten lexuesit për ta përsëritur procesin e verifikimit.
- F. Të sigurojnë prova për çdo deklaratë faktike që bëjnë si pjesë të një hetimi, duke u mbështetur, sa herë që është e mundur, në burimet parësore. Të paraqesin në verifikimet e fakteve si provat relevante që duket se e mbështesin një pretendim, ashtu edhe provat që duket se janë në kundërshtim me të.
- G. Të paraqesin të paktën dy, por mundësisht edhe më shumë, burime për të verifikuar pretendimin kryesor të një hetimi, përveçse kur ka vetëm një burim relevant. Të përdorin burimet më të mira të disponueshme parësore, jo dytësore, të provave sa herë që ka burime të përshtatshme parësore. Në rastet kur nuk ka burime të përshtatshme parësore, aplikanti duhet të shpjegojë pse ka përdorur një burim dytësor.
- H. Të japin emrat e të gjitha burimeve, përveçse kur vihet në rrezik siguria e tyre. Kur bëhen përjashtime të tilla, mund të përfshihen burime anonime vetëm nëse informacioni që ata ofrojnë konfirmohet nga burime me emër ose me prova materiale.
- I. Kur citohen ekspertë, duhet të vërtetohet besueshmëria e tyre në fushën përkatëse.
- J. Duhet të marrin masa që çdo hetim t'i nënshtrohet të paktën një raundi redaktimi nga një person i dytë, i ndryshëm nga autori, përpara se të publikohet.
- K. T'i paraqesin gjetjet, duke përdorur një gjuhë të saktë, faktike dhe jo emocionale, duke u kujdesur që të mos dalin në më shumë përfundime sesa duhet.

Përveç këtyre masave, Kodi identifikon këto praktika si praktikatat më të mira që inkurajohen dhe që do të vlerësohen nga vlerësuesit gjatë procesit të aplikimit:

- L. Raportimi mbi ndikimin që ka operacioni subjekt vlerësimi në çështjet me interes publik.

KAPITULLI 3: STANDARDET ETIKE

Neni 3: Standardet etike

Anëtarët e Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve **duhet të veprojnë në bazë të standardeve etike strikte** për të mbrojtur pavarësinë dhe besueshmërinë e tyre. Në punën që shpesh përfshin përmbajtje të krijuar nga përdoruesit, duhet pasur kujdes që të respektohet privatësia dhe siguria e subjekteve të përfshira.

Neni 3. 1: Pavarësia dhe paanshmëria

Për t'u njohur si anëtar i verifikuar i Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve (EFCSN), operacionet duhet:

- A. Të jenë të lirë editorialisht dhe të pavarur politikisht.
- B. Të mos e nxisin dhe të mos e këshillojnë publikun që të votojë për parti politike apo për kandidatë të caktuar që garojnë për poste publike.
- C. Të mos lidhin asnjë marrëveshje ose partneritet me parti politike dhe të mos vendosin asnjë marrëdhënie tjetër me publikun dhe me aktivitete të ngjashme që mund të kompromentojnë reputacionin e operacionit si një operacion i pavarur dhe i paanshëm.
- D. Të mos i fokusojnë hetimet në mënyrë të padrejtë në një parti të caktuar politike dhe as në anë të caktuara të spektrit politik.
- E. Të mos punësojnë asnjë person të punësuar me pagë apo që mban një post të lartë në një parti politike, në qeveri, në shoqëri shtetërore ose publike nën kontrollin e drejtpërdrejtë të një partie politike apo të një qeverie.
- F. Të trajtojnë në mënyrë të qartë në publikime çdo konflikt të arsyeshëm interesi ose njëanshmëri politike, duke përfshirë edhe ato që mund të vijnë nga ekspertët ose nga organizatat e cituara.
- G. Të kenë politikat e tyre të brendshme që i ndalojnë punonjësit të bëjnë deklarata partiake në emër të operacionit apo të organizatës, si dhe procedura për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në rast shkeljesh. Operacionet duhet të ndërmarrin masa për t'u siguruar që çdo mbrojtje ose pikëpamje lidhur me politika të ndryshme nga stafi të menaxhohet në mënyrë të tillë që një anëtar i arsyeshëm i publikut të mos e shohë punën e organizatës si të njëanshme.
- H. Të kenë politika të brendshme që e ndalojnë pranimin nga ana e punonjësve në një kontekst profesional të çdo dhurate, favori dhe shërbimi me kushte të favorshme që shkon përtej atyre që do të konsideroheshin norma të zakonshme sociale dhe mirësjelljeje, si dhe të kenë procedura për ndërmarrjen e masave në rast shkeljesh.
- I. T'i bëjnë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen e tyre të internetit këto politika dhe çdo politikë tjetër për paanshmëri (Shih modelin në Aneksin 3).
- J. Të avokojnë vetëm për çështje që janë të rëndësishme për misionin e verifikimit të

fakteve dhe që janë në përputhje me reputacionin e të qenit të pavarur dhe të paanshëm. Organizatat që angazhohen në avokim duhet të bëjnë publike mënyrën se si u përmbahen këtyre standardeve.

Neni 3. 2: Privatësia dhe Siguria

Për t'u njohur si anëtar i verifikuar i Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve (EFCSN), operacionet duhet:

- A. Të fshehin imazhin dhe/ose identitetin e subjekteve të një hetimi kur ekziston një shqetësim i arsyeshëm për sigurinë e tyre.
- B. Të marrin masa për të shmangur ekspozimin e burimit ose të identitetit të përmbajtjeve dezinformuese të gjeneruara nga përdoruesit ndaj një shqyrtimi të panevojshëm publik.
- C. Të jenë të kufizuar, të respektueshëm dhe të vëmendshëm kur përmendin ose identifikojnë persona të mitur dhe të bëjnë përpjekje për të mbrojtur privatësinë e tyre.
- D. Të anonimizojnë çdo informacion personal që mund të krijojë hapësirë për ngacmimin e personave të caktuar (p.sh. duke fshirë të paktën pjesërisht numrat e telefonit, ID-të ose pasaportat, numrat e llogarive bankare, adresat e emailit...)
- E. Kur është e përshtatshme dhe e mundur, çdo personi ose organizate të përmendur që është burimi i një pretendimi të pasaktë dhe/ose që është subjekt i kritikave ose pretendimeve të rëndësishme duhet t'i ofrohet e drejta e përgjigjes.

Përveç këtyre masave, Kodi identifikon këto praktika si praktikatat më të mira që inkurajohen dhe që do të vlerësohen nga vlerësuesit gjatë procesit të aplikimit:

- F. Marrjen e masave që synojnë trajtimin e rrezikut të traumës ose ngacmimeve të përjetuara nga stafi si rezultat i aktiviteteve të operacionit, duke përfshirë edhe ofrimin e trajnimeve për parandalimin dhe identifikimin e simptomave, por pa u kufizuar me atë.

Neni 3. 3: Korrigjime të ndershme

Për t'u njohur si anëtar i verifikuar i Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve (EFCSN), operacionet duhet:

- A. Të korrigjojnë menjëherë çdo gabim që dihet përmes një shënimi korrigjimi në të njëjtin publikim ku është bërë gabimi; nëse gabimi është vetëm tipografik, gramatikor ose stilistik, nuk ka nevojë për shënim korrigjimi.
- B. Kur publikimi origjinal ku është bërë gabimi nuk është i modifikueshëm, ata duhet ta shpërndajnë korrigjimin në të njëjtin format dhe kanal si origjinali, në mënyrë që korrigjimin dhe versionin e korrigjuar të origjinalit ta shohin sa më shumë përdorues që të jetë e mundur.
- C. Nëse një gabim është thelbësor, që do të thotë se ndryshon rrënjësisht përfundimet e

hetimit ose që largohet qartësisht nga metodologjia dhe politikat e operacionit, të përfshijnë në shënimin e korrigjimit informacionin e saktë, si dhe një shpjegim të rrethanave që kanë lejuar shfaqjen e atij gabimi. Më pas, duhet ta shpërndajnë korrigjimin në të njëjtin format dhe në të njëjtat kanale si origjinali.

- D. Të bëjnë të ditur shtimin e çfarëdo informacioni të ri në një publikim përmes një shënimi përditësues në po atë publikim.
- E. Të bëjnë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme në faqet e tyre të internetit politikën e tyre të korrigjimit, si dhe historikun e korrigjimeve të publikuara gjatë vitit të kaluar në aplikimin e parë për anëtarësim në EFCSN dhe të dy viteve të mëparshme në rast rinovimi të anëtarësisë.
- F. Të përfshijnë në politikën e tyre të korrigjimeve, që e bëjnë publike dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen e tyre të internetit, edhe një përshkrim të hollësishëm të mënyrës se si i vlerësojnë kërkesat për korrigjime.
- G. T'i ofrojnë audiencës kanale të drejtpërdrejta për të kërkuar një korrigjim, brenda politikës së korrigjimeve në faqen e tyre të internetit.
- H. Ta informojnë audiencën për mundësinë e paraqitjes së një ankese në EFCSN sipas kushteve të nenit 6, duke vendosur aty edhe linkun që të çon tek formulari i ankesës.

Përveç këtyre masave, Kodi identifikon edhe këto praktika si praktikatat më të mira që inkurajohen dhe që do të vlerësohen nga vlerësuesit gjatë procesit të aplikimit:

- I. Bërjen e një analize të brendshme vjetore të dokumentuar të korrigjimeve të publikuara për të përcaktuar nëse duhen bërë ndryshime metodologjike dhe procedurale për të shmangur përsëritjen e të njëjtave gabime në të ardhmen.
- J. Ofrimin e një shqyrtimi të pavarur të një ankese nëse subjekti i një artikulli nuk është i kënaqur me ndjekjen e procesit të brendshëm të shqyrtimit të ankesave.

KAPITULLI 4: TRANSPARENCA

Neni 4: Transparenca

Anëtarët e Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve **duhet të jenë transparentë në lidhje me strukturën e tyre organizative, financimin, partneritetet dhe marrëveshjet** në mënyrë që të **nxisin besimin dhe llogaridhënien te publiku**. Anëtarët e verifikuar duhet të bëjnë të ditur pronësinë, statusin juridik dhe mënyrën e menaxhimit të organizatave të tyre. Ata gjithashtu duhet të shpjegojnë formimin profesional të të gjithë stafit kryesor në operacionin e tyre të verifikimit të fakteve dhe në strukturën e tyre organizative.

Neni 4.1: Transparenca organizative

Për t'u njohur si anëtarë të verifikuar të Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të

Fakteve (EFCSN), operacionet duhet:

- A. Të vënë në dispozicion dhe të bëjnë lehtësisht të aksesueshme në faqen e tyre të internetit një deklaratë që përcakton strukturën organizative të aplikantit dhe ku duket qartë se si dhe nga kush ushtrohet kontrolli editorial.
- B. Të vënë në dispozicion dhe të bëjnë lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit informacione të përditësuara rregullisht në lidhje me pronësinë dhe statusin juridik të operacionit dhe/ose të organizatës mëmë. Personat ose subjektet që zotërojnë mbi 5% të aksioneve duhet të bëhen të ditur (shih modelin në Aneksin 4).
- C. Të vënë në dispozicion dhe të bëjnë lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit informacione të përditësuara rregullisht në lidhje me menaxhimin e operacionit dhe/ose të organizatës mëmë (shih formularin model në Aneksin 5).
- D. Të paraqesin dokumentet për vërtetimin e pronësisë, të statusit juridik dhe të menaxhimit të organizatës për vlerësuesit e jashtëm dhe për Organin Drejtues; ky informacion nuk ka nevojë të bëhet publik (shih formularin model në Aneksin 6).
- E. Të vënë në dispozicion dhe të bëjnë lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit informacione të përditësuara rregullisht në lidhje me identitetin e redaktorëve ose të vendimmarrësve që qëndrojnë pas operacionit, duke përfshirë çdo rol përkatës që ata kanë pasur më parë.
- F. Të vënë në dispozicion dhe të bëjnë lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit informacione të përditësuara rregullisht në lidhje me pozicionet e mbajtura nga i gjithë stafi i përfshirë në punën editoriale të operacionit të verifikimit të fakteve, duke përfshirë çdo rol përkatës të mëparshëm.
- G. Të vënë në dispozicion dhe të bëjnë lehtësisht të aksesueshme në faqen e tyre të internetit një deklaratë ku përcaktohen misioni, vlerat dhe udhëzimet e brendshme të operacionit për të mbrojtur pavarësinë e tij.
- H. Të vënë në dispozicion dhe të bëjnë lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit aktet nënligjore të organizatës, që nënkuptojnë rregullat ose statutet sipas të cilave duhet të veprojnë anëtarët e një organizate.

Nëse Organi Drejtues miraton një kërkesë, në të cilin gjykohet se përmbushja e kërkesave të organizatës për transparencë mund të rezultojë në sanksione nga shteti, sanksione të nxitura politikisht ose në çfarëdolloj forme tjetër dhune ndaj një organizate ose anëtarëve të saj, ky informacion mund t'i bëhet i ditur përjashtimisht vetëm Organit Drejtues të këtij Kodi dhe vlerësuesve të tij. Ky apel duhet të shpjegohet në një letër drejtuar Organit Qeverisës.

Neni 4. 2: Transparenca financiare dhe konfliktet e interesit

Për t'u njohur si anëtare të verifikuara të Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve (EFCSN), organizatat ose organizatat mëmë duhet:

- A. T'i bëjnë të ditura Organit Drejtues dhe vlerësuesve të tij të gjitha burimet e të ardhurave që kontribuojnë me 1% ose me 5.000 euro (cilado shifër që rezulton më e larta), nga

llogaritë vjetore më të fundit në momentin e anëtarësimit dhe nga dy llogaritë e fundit vjetore në rast rinovimi të anëtarësisë; ky informacion nuk ka nevojë të bëhet publik, por do të ruhet si informacion konfidencial (shih formularin model në Aneksin 7).

Një aplikant mund edhe të kërkojë që në vend që t'ia bëjë të ditura këto informacione atyre që përmenden më lart, t'ia dorëzojë këtë informacion një audituesi të jashtëm. Organi Drejtues mund ta pranojë këtë kërkesë vetëm nëse bindet se ekzistojnë arsye të mjaftueshme ligjore, tregtare, arsye sigurie ose arsye të tjera për ta pranuar një kërkesë të tillë dhe se kjo është në interesin më të mirë të EFCSN-së.

Organi Drejtues, në marrëveshje me aplikantin, cakton një auditues të jashtëm me historik dhe me reputacion të mirë, që nuk ka marrëdhënie ekzistuese me aplikantin. Shpenzimet mbulohen nga aplikanti, përveçse kur Organi Drejtues vendos t'i mbulojë vetë.

Nëse audituesi sheh një konflikt të mundshëm interesi në burimet e të ardhurave të aplikantit, ai duhet t'i raportojë Organit Drejtues, vlerësuesve dhe aplikantit një përmbledhje të gjetjeve të tij, duke përfshirë edhe numrin e konflikteve dhe llojet e konflikteve, por pa identifikuar burimet e konfliktit. Nëse aplikanti zgjedh të vazhdojë me aplikimin, audituesi duhet t'i dorëzojë një raport të plotë Organit Drejtues dhe vlerësuesve, të cilët vendosin se çfarë informacionesh duhet të bëhen të ditura në përputhje me nenin 4.2.B.

- B. Të bëjnë të disponueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit një deklaram të përditësuar të të ardhurave të përgjithshme vjetore të organizatës. Në atë deklaram, duhet të përcaktojnë burimet e tyre kryesore të të ardhurave duke përfshirë, edhe ata që kontribuojnë me mbi 5% të të ardhurave të tyre vjetore për llogaritë vjetore më të fundit në rast anëtarësimi dhe për dy llogaritë e mëparshme vjetore në rast rinovimi të anëtarësimit, por pa u kufizuar domosdoshmërisht tek ato burime. Në këtë deklaram duhet gjithashtu të renditen të gjitha burimet e të ardhurave nga platformat online, financuesit publikë (kombëtarë ose ndërkombëtarë) dhe/ose çdo burim tjetër të ardhurash që mund të sjellë konflikt interesi siç kuptohet nga Organi Drejtues (shih formularin model në Aneksin 8).
- C. Të bëjnë të disponueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm në faqen e tyre të internetit një shpjegim të mekanizmave të ngritur për të siguruar pavarësinë editoriale, si dhe një shpjegim të natyrës së punës së financuar nga çdo platformë, burim publik (kombëtar ose ndërkombëtar) dhe çdo burim tjetër të ardhurash që mund të sjellin një konflikt interesi siç kuptohet nga Organi Drejtues.
- D. Të bëjnë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen e tyre të internetit një deklaratë të përditësuar të të gjitha angazhimeve të rëndësishme të papaguara të bëra ndaj organizatave të tjera (shih Aneksin 9).
- E. Të bëjnë të ditur publikisht dhe të identifikojnë qartë përmbajtjet e sponsorizuara, që nënkupton materialet në publikime në internet që ngjasojnë me përmbajtjet editoriale të publikimeve, por që paguhen nga një reklamues dhe që synojnë të promovojnë një produkt apo shërbim të reklamuesit, në brendësi të çdo publikimi të sponsorizuar. Përmbajtjet fakt-verifikuese nuk mund të jenë në asnjë rrethanë përmbajtje të sponsorizuara.

F. Të bëjnë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen e tyre të internetit mallrat dhe shërbimet që ata marrin nga burime të jashtme, duke përfshirë edhe abonimet me pagesë ose aksesin falas në mjete, softuer dhe/ose në reklama, që përbëjnë një ndryshim material në financat e tyre (5% të të ardhurave neto).

G. Të plotësojnë të gjitha deklaratat e transparencës në mënyrë të plotë dhe të ndershme. As vlerësuesit dhe as Organi Drejtues nuk e kanë fuqinë e nevojshme për t'i verifikuar ato deklaratat. Prandaj, nëse dalin informacione që vërtetojnë se një pjesë e deklaratës së transparencës nuk është e plotë apo e ndershme sa duhet, do të hapet një procedurë sanksionimi.

Nëse Organi Drejtues miraton një kërkesë, sipas së cilës përmbushja e kërkesave për transparencë financiare mund të rezultojë në mënyrë të arsyeshme në sanksione nga shteti, të nxitura politikisht, ose në çfarëdolloj forme tjetër dhune ndaj organizatës ose anëtarëve të saj, ky informacion mund t'i bëhet i ditur përjashtimisht vetëm Organit Drejtues të këtij Kodi dhe vlerësuesve të tij. Kjo kërkesë duhet të shpjegohet në një letër drejtuar Organit Drejtues.

Përveç këtyre masave, Kodi identifikon edhe këto praktika si praktikë më të mira që inkurajohen dhe që do të vlerësohen nga vlerësuesit gjatë procesit të aplikimit:

H. Të bëjnë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen e tyre të internetit të gjitha llogaritë vjetore të organizatës për çdo vit që nga anëtarësimi në EFCSN.

KAPITULLI 5: AKSESI DHE RINOVIMI

Neni 5: Aksesi

Për t'u anëtarësuar në Rrjetin Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve, operacioni i interesuar, siç përcaktohet në Hyrje, duhet të paraqesë një aplikim, i cili i nënshtrohet një procedure vlerësimi.

Në fund të kësaj procedure, secili anëtar i miratuar merr një distinktiv i cili duhet të publikohet në faqen e tij të internetit. Operacionet që e marrin këtë distinktiv do të renditen edhe në faqen e internetit të EFCSN së bashku me aplikimin e tyre, në mënyrë që lexuesit të mund të kontrollojnë nëse ata janë anëtarë të verifikuar.

Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që i atribuohen Organit Drejtues në këtë kapitull mund t'i delegohen, nga vetë organi drejtues, një tjetër organi të caktuar, karakteristikat e të cilit do të përcaktohen në detaje në një dokument të veçantë, bashkëlidhur këtij Kodi.

Neni 5. 1: Procedura e vlerësimit

A. Fjalën e fundit për anëtarësimin e ka Organi Drejtues. Për të qenë i vlefshëm, vendimi kërkon një shumicë të cilësuar të $\frac{2}{3}$ të anëtarëve me të drejtë vote të Organit Drejtues. Që ky vendim të jetë i vlefshëm, anëtarët me të drejtë vote duhet të jenë të paktën 50%

+1 të totalit të anëtarëve të Organit Drejtues. Vendimi duhet të bazohet te “Kriteret” e përcaktuara në nenin 5.2.

- B. Para votimit, Organi Drejtues merr mendimet e dy vlerësuesve të jashtëm (shih nenin 5.4), asnjëri prej të cilëve nuk e di se kush është vlerësuesi tjetër. Organi Drejtues kërkon gjithashtu edhe mendimin e anëtarëve të Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve nga i njëjti vend me aplikantin ose, nëse nuk ka anëtarë nga ai vend, nga i njëjti rajon gjeografik, siç përshkruhet nga metodologjia e OKB-së që e ndan Evropën në 4 nënrajone: Evropa Lindore, Evropa Perëndimore, Evropa Veriore dhe Evropa Jugore. Vendimet e vlerësuesve të jashtëm dhe mendimet e anëtarëve të Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve nga i njëjti vend/rajon gjeografik duhet të adresojnë “Kriteret” e përcaktuara në nenin 5.2. dhe të jenë pjesë e vlerësimit, por jo të detyrueshme për Organin Drejtues.
- C. Kur një organizatë punon në disa gjuhë, ajo duhet të ofrojë dëshmi se i zbaton njësoj standardet në të gjitha ato gjuhë. Nëse këto dëshmi konsiderohen të mjaftueshme nga Organi Drejtues, organizata do të vlerësohet në të paktën dy gjuhë që do të zgjidhen vetë Organi Drejtues. Nëse provat nuk konsiderohen të mjaftueshme, do të kryhen vlerësime të veçanta për secilën gjuhë në të cilën punon organizata. Të gjitha kërkesat e bëra publike në këtë Kod duhet të plotësohen në të gjitha gjuhët në të cilat punon organizata.
- D. Vendimi përfundimtar i Organit Drejtues duhet të shpjegohet. Rezultati përfundimtar duhet të bëhet publik. Vendimet përfundimtare mund të jenë:
- “Miratimi”, në rast miratimi të plotë dhe përfundimtar
 - “Në pritje të vendimi”, nëse Organi Drejtues kërkon më shumë informacion nga aplikanti përpara se të marrë një vendim përfundimtar.
 - “Refuzimi”, në rast refuzimi të plotë dhe përfundimtar
- E. Organi Drejtues duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për t'u siguruar që e gjithë procedura e Vlerësimit të përfundojë brenda një periudhe jo më të gjatë se 90 ditësh pune.
- F. Organi Drejtues duhet të mbajë një regjistër të vendimeve për rastet e jashtëzakonshme të aksesit për të siguruar qëndrueshmëri në aplikimin dhe interpretimin e Kodit ndërmjet anëtarëve.

Neni 5. 2: Kriteret

- A. Aplikanti duhet të jetë një organizatë e regjistruar ligjërisht, ose një operacion i veçantë brenda një organizate të regjistruar ligjërisht, detajet e të cilit duhet të gjenden lehtësisht në faqen e tij të internetit.
- B. Ky operacion apo kjo organizatë duhet të jetë krijuar kryesisht me qëllim verifikimin e fakteve, siç përcaktohet në Hyrje.
- C. Aplikanti duhet të jetë i fokusuar në mënyrë thelbësore dhe të demonstrueshme në një (ose më shumë) nga vendet e Këshillit të Evropës, ose edhe në Kosovë ose në Bjellorusi.
- D. Aplikantët duhet të ofrojnë prova për të demonstruar se kanë publikuar mesatarisht

katër artikuj origjinalë fakt-verifikues çdo muaj pa ndërprerje gjatë vitit të kaluar.

- E. Artikujt ose hetimet e aplikantit duhet të fokusohen kryesisht te pretendimet që lidhen me çështje që, sipas mendimit të Organit Drejtues, kanë të bëjnë me interesin publik.
- F. Aplikanti duhet të veprojë në përputhje me standardet metodologjike, të përcaktuara në Kapitullin 2.
- G. Aplikanti duhet të veprojë në përputhje me standardet etike, të përcaktuara në Kapitullin 3 të Kodit Evropian të Standardeve.
- H. Aplikanti duhet të veprojë në përputhje me kërkesat për transparencë organizative dhe financiare, siç përcaktohet në Kapitullin 4 të Kodit Evropian të Standardeve.

Neni 5. 3: Formulari i aplikimit

Plotësimi i kritereve të përcaktuara në nenin 5.2 do të vlerësohet në bazë të një formulari aplikimi, me pyetje të standardizuara.

Neni 5. 4: Vlerësuesit

Vlerësuesit e jashtëm të përmendur në nenin 5.1 duhet të kenë ekspertizë të dëshmuar në fushën e verifikimit të fakteve dhe të dezinformimit dhe nuk duhet të kenë konflikt interesi me organizatën që u kërkohet të vlerësojnë. Ata nuk duhet të jenë staf i organizatave që janë ndërkohë anëtare të EFCSN.

Në Aneksin 10 përcaktohet një sistem rotacioni për t'u siguruar që e njëjta organizatë të mos vlerësohet në mënyrë të njëpasnjëshme nga të njëjtët vlerësues.

Neni 5. 5: Rishqyrtimi

Në përgjigje të një vendimi refuzues të Organit Drejtues, aplikanti mund të paraqesë një formular ankimi sipas procedurës së mëposhtme:

- A. Ankesa duhet të paraqitet brenda muajit nga momenti i refuzimit.
- B. Procedura e vlerësimit të ankimit është e njëjtë si për aplikimin e parë për anëtarësim, por vlerësuesit e jashtëm duhet të jenë të ndryshëm, jo të njëjtët.
- C. Në rast refuzimi të ankesës, aplikantit nuk i lejohet të paraqesë aplikim të ri për 12 muajt në vijim.

Neni 5. 6: Rinovimi

- A. Anëtarësimi në Rrjetin Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve mbaron 24

muaj pas dhënies së pranimit zyrtar, përveçse në rast situatash të jashtëzakonshme siç kuptohet nga Organi Drejtues.

- B. Për rinovimin e anëtarësimit mund të paraqitet një aplikim, të paktën 21 muaj pas pranimit të fundit zyrtar.
- C. Formulari i aplikimit, kriteret dhe procedura janë të njëjta si për aplikimin e parë të anëtarësimit në Rrjetin Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve.
- D. Nëse ndodhin ndryshime të rëndësishme në pronësinë ose në drejtimin e një organizate që është tashmë anëtare e Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve, organizata duhet ta njoftojë Rrjetin Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve brenda muajit të ardhshëm vijim. Në këtë rast, Organi Drejtues i Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve ka fuqinë të vendosë me konsensus nëse nevojitet rinovimi i anëtarësisë qoftë edhe para datës së përfundimit të anëtarësimit ekzistues.

KAPITULLI 6: PAJTUESHMËRIA DHE ZBATIMI

Neni 6: Pajtueshmëria

Çdo individ ose organizatë që beson se një anëtar i Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve nuk ka përmbushur ndjeshëm kërkesat e këtij Kodi, nëse kjo ankesë nuk është adresuar në mënyrë të kënaqshme nga organizata në fjalë, mund të paraqesë një ankesë në Rrjetin Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve për vlerësim nga Organi Drejtues (shih nenin 6.1).

Organi Drejtues nuk shqyrton çështje që lidhen me një publikim të vetëm, përveçse në rastet kur ky publikim përbën shkelje të konsiderueshme të kërkesave të këtij Kodi.

Ankesa duhet të dorëzohet përmes një formulari specifik (shih Aneksin 11), i vënë në dispozicion në faqen e internetit të Rrjetit Evropian të Standardeve për Verifikimin e Fakteve.

Mundësia për përfshirjen e Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve në rastet kur një ankesë nuk trajtohet nga organizata në fjalë, duhet të specifikohet në faqet e internetit të të gjithë anëtarëve të rrjetit, në politikën e tyre të korrigjimeve (shih nenin 3.3).

Neni 6.1: Shqyrtuesi i ankesave

Organi Drejtues mund të caktojë një rishikues të ankesave për të ndihmuar me ankesat e marra kundër anëtarëve të EFCSN.

Detyrat kryesore të rishikuesit të ankesave janë:

- A. Analizimi paraprak i të gjitha ankesave dhe informimi i Organit Drejtues për çdo ankesë të refuzuar për shkak se ka qenë e pasinqertë, përbënte ngacmim ose është qartësisht e pabazë.

- B. Identifikimi i gabimeve në një artikull ose në një hetim të caktuar që përfaqësojnë shkelje të konsiderueshme të kodit, por që mund të zgjidhen me një korrigjim të thjeshtë, të paktën në rastet kur organizata objekt i ankesës nuk ka një strukturë të pavarur për shqyrtimin e ankesave që nuk janë trajtuar në mënyrë bindëse.
- B.1 Njoftimi i organizatës anëtare në fjalë, duke specifikuar korrigjimin që duhet bërë dhe duke i kërkuar anëtarit që ta bëjë këtë brenda 7 ditëve të ardhshme të punës.
 - B.2 Nëse anëtari i plotëson këto kushte, njoftimi i ankuesit për korrigjimin.
 - B.3 Nëse anëtari nuk i plotëson këto kushte, njoftimi i Organit Drejtues, i cili do të vlerësojë ankesën.
- C. Njoftimi i Organit Drejtues për rastet e shkeljeve të përsëritura ose madhore.

Neni 6. 2: Procedura e pajtueshmërisë

- A. Organi Drejtues, kur merret me akuza për mosrespektim të konsiderueshëm të Kodit, është organi që thotë fjalën e fundit në lidhje me pajtueshmërinë e organizatës anëtare. Për të qenë i vlefshëm, vendimi nëse ka pasur apo jo shkelje duhet të merret nga një shumicë e cilësuar prej $\frac{2}{3}$ të anëtarëve me të drejtë vote të Organit Drejtues. Që ky vendim të jetë i vlefshëm, anëtarët me të drejtë vote duhet të jenë të paktën 50% +1 të totalit të anëtarëve të Organit Drejtues.
- B. Përpara votimit, Organi Drejtues duhet t'i japë organizatës së akuzuar për mosplotësim të kërkesave të Kodit të drejtën për t'u përgjigjur dhe për t'u mbrojtur, si dhe të drejtën për të kërkuar opinionin autoritar, por jo të detyrueshëm, të një vlerësuesi të jashtëm (shih nenin 5.4).
- C. Në opinionin e vlerësuesit të jashtëm duhet të trajtohet çdo mospërbushje e kërkesave të Kodit, shkalla e mospërbushjes dhe sanksioni që ai propozon ose spektri i sanksioneve që ai mendon se duhet të ndërmerren në rastin në fjalë.
- D. Vendimi përfundimtar i Organit Drejtues duhet të shpjegohet. Rezultati përfundimtar u komunikohet palëve të interesuara brenda 7 ditëve të ardhshme të punës dhe vendimi bëhet publik në një "Raport vjetor". Ky "Raport vjetor" duhet të publikohet brenda 6 muajve të parë nga mbyllja e vitit në fjalë.
- E. E gjithë procedura e Pajtueshmërisë duhet të përfundojë brenda jo më shumë se 60 ditësh pune dhe vendimi i Organit Drejtues konsiderohet përfundimtar dhe i detyrueshëm.
- F. Anëtarët e Organit Drejtues duhet të tërhiqen nga vlerësimet e organizatave ku bëjnë pjesë ata vetë për të shmangur konfliktin e interesit.

Neni 6. 3: Sanksionet

Ashpërsia e sanksionit të vendosur lidhet gjithmonë me shkallën e shkeljes së Kodit.

Sanksionet që mund të ndërmerren, nga më i lehti deri te më i ashpri, janë:

- këshillimi ose qortimi formal privat ku specifikohen hapat që duhet të ndërmarrë organizata;
- qortimi zyrtar publik ku specifikohen hapat që duhet të ndërmarrë organizata;
- pezullimi i së drejtës së votës së organizatës në të gjitha organet e EFCSN-së, për një periudhë që varion nga 3 muaj deri në 3 vjet;
- pezullimi i anëtarësimit për një periudhë që varion nga 3 muaj deri në 3 vjet;
- çanëtarësimi dhe moslejimi i riaplikimit për një periudhë që varion nga 3 deri në 5 vjet;

Mosrespektimi në mënyrë të përsëritur i kërkesave të Kodit përmes sjelljesh identike ose të ngjashme përbën shkak për ndërmarrjen e sanksioneve më të rënda.

KAPITULLI 7: EVOLUIMI DHE NDRYSHIMET

Neni 7: Evoluimi i Kodit

Përmbajtja e Kodit do të rishikohet periodikisht, për ta mbajtur atë sa më të përditësuar.

- Rishikimi i parë i përgjithshëm do të bëhet një vit pas hyrjes në fuqi të Kodit për herë të parë; rishikimi i dytë i përgjithshëm do të bëhet 2 vjet pas rishikimit të parë; më pas, rishikimet e përgjithshme do të bëhen çdo 5 vjet;
- Nëse shumica e cilësuar e $\frac{2}{3}$ të të gjithë anëtarëve të Organit Drejtues kërkon rishikimin e ndonjë pjese të Kodit, Organi Drejtues do ta organizojë një rishikim të tillë në çfarëdolloj kohe brenda 6 muajve në vijim;
- Nëse $\frac{2}{5}$ e anëtarëve të Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve kërkojnë zyrtarisht të rishikojnë ndonjë pjesë të Kodit, në çfarëdolloj kohe, Organi Drejtues duhet ta organizojë një rishikim të tillë brenda 6 muajve në vijim;
- Çdo 12 muaj pas hyrjes në fuqi të Kodit, Organi Drejtues duhet t'u raportojë anëtarëve të Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve për çdo fushë të Kodit që mund të përmirësohet, dhe të propozojë ndryshime për këtë qëllim, duke specifikuar se cilat ndryshime konsiderohen "madhore" dhe cilat "të vogla" (shih nenin 7.1).
- Anëtarët e Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve mund të propozojnë ndryshime dhe vlerësime të efektivitetit të Kodit, në çdo kohë, nëpërmjet një adrese të dedikuar emaili.

Neni 7.1: Procedura

Organi Drejtues duhet të vendosë, të paktën një herë në 12 muaj, se cilat ndryshime të propozuara janë "të vogla" dhe cilat janë "madhore", me votim me shumicë të cilësuar prej $\frac{3}{4}$ të anëtarëve me të drejtë vote të Organit Drejtues. Që ky vendim të jetë i vlefshëm, anëtarët me të drejtë vote duhet të jenë të paktën 50% +1 të totalit të anëtarëve të Organit Drejtues. Organizatat anëtare të Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve duhet të informohen menjëherë për vendimin e marrë.

- A. Ndryshimet “e vogla” miratohen nga vetë Organi Drejtues, me shumicë të cilësuar prej 3/4 të anëtarëve me të drejtë vote të Organit Drejtues. Që ky vendim të jetë i vlefshëm, anëtarët me të drejtë vote duhet të jenë të paktën 50% +1 të totalit të anëtarëve të Organit Drejtues.
- B. Ndryshimet “madhore” në Kod miratohen nga të gjithë anëtarët e Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve, me një shumicë të cilësuar prej 3/4 të të gjithë anëtarëve. Që ky vendim të jetë i vlefshëm, anëtarët me të drejtë vote duhet të jenë të paktën 50%+1 e të gjithë anëtarëve.

Çdo organizatë mund të kundërshtojë vendimin e Organit Drejtues, për ndryshimet “e vogla” ose “të mëdha”, brenda 15 ditëve të ardhshme. Brenda 15 ditëve në vijim, Organi Drejtues duhet të informojë të gjithë anëtarët e Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve për kundërshtime të ngjashme dhe për mundësinë e mbështetjes së tyre. Nëse këto kundërshtime mbështeten nga të paktën prej 1/5 e të gjithë anëtarëve, Organi Drejtues i rikualifikon ndryshimet në përputhje me rrethanat dhe ndjek procedurën përkatëse. Nëse nuk ka kundërshtime, ose nëse 15 ditë pas vendimit të Organit Drejtues, kundërshtimet ekzistuese nuk mbështeten nga të paktën 1/5 e anëtarëve të Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve, Organi Drejtues voton për ndryshimet e vogla, duke ndjekur procedurën e përcaktuar në nenin 7.1 germa A), brenda 15 ditëve në vijim.

ANEKSET

Aneksi 1. Anëtarët e Grupit të Gjerë

Anëtarët e Grupit të Gjerë dhe vendet ku bazohen operacionet:

- 15min, Lituani
- AFP, Francë
- Correctiv, Gjermani
- Delfi, Lituani
- Demagog, Poloni
- Doğruluk Payı, Turqi
- Deutsche Presse-Agentur (dpa), Gjermani
- Eesti Päevaleht, Estoni
- EFE Verifica, Spanjë
- Ellinika Hoaxes, Greqi
- EU DisinfoLab, Belgjikë
- Factual.ro, Ruman
- FakeNeës Tragaç, Serbi
- Fakt Yoxla, Azerbajxhan
- Faktisk.no, Norvegji
- Faktograf, Kroaci
- Faktoje, Shqipëri
- france.tv, Francë
- Full Fact, Mbretëria e Bashkuar
- Fundación Maldita.es, Spanjë
- Bashkëpunëtorët e reformave të Gjeorgjisë, Gjeorgji
- Hibrid.info, Kosovë
- Istinomer, Serbi
- Källkritikbyrån, Suedi
- Kallxo, Kosovë
- Knack, Belgjikë
- KRIK, Serbi
- Les Surligneurs, Francë
- Logically, Mbretëria e Bashkuar
- Fondacioni për Zhvillimin e Medias, Gjeorgji
- Fondacioni Metamorfozis, Maqedonia e Veriut
- mimikama, Austri
- Newtral, Spanjë
- Observador, Portugali
- Open Fact-checking, Itali
- Oštro, Slloveni
- Pagella Politica/Facta, Itali
- Polígrafo, Portugali
- Shoqata Pravda, Poloni
- Raskrinkavanje (Qendra për Tranzicionin Demokratik), Mali i Zi

- Re:Check, Letoni
- Science Feedback, Francë
- STOP FALS!, Republika e Moldavisë
- Teyit, Turqi
- The Journal, Irlandë
- TjekDet.dk, Danimarkë
- Verificat, Spanjë
- VoxUkraine, Ukrainë
- Zašto ne (në përfaqësi të Raskrinkavanjes dhe Istinomjer), Bosnje-Hercegovinë

Aneksi 2. Anëtarët e Komitetit të Punës

Anëtarët e Komitetit të Punës dhe vendet ku bazohen operacionet:

- Delfi, Lituani
- Deutsche Presse-Agentur (dpa), Gjermani
- Factual.ro, Rumani
- Full Fact, Mbretëria e Bashkuar
- Kallxo, Kosovë
- Logically, Mbretëria e Bashkuar
- Shoqata Pravda, Poloni
- STOP FALS!, Republika e Moldavisë
- Teyit, Turqi
- TjekDet.dk, Danimarkë
- Verificat, Spanjë
- Zašto ne (në përfaqësi të Raskrinkavanjes dhe Istinomjer), Bosnje-Hercegovinë

Aneksi 3. Modeli i Nenit 3. 1. I

Ky model ose një format i ngjashëm që përmban këtë informacion duhet të jetë i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen tuaj të internetit:

[*Emri i operacionit*] nuk është nën kontrollin editorial të shtetit, të ndonjë partie politike apo të ndonjë politikani dhe nuk i përqendron hetimet në një parti politike apo në ndonjë pjesë të caktuar të spektrit politik.

Ky operacion nuk do të punësojë asnjë person që mban një pozicion të paguar ose një post të lartë në ndonjë parti politike, në qeveri apo në kompani publike nën kontrollin e drejtpërdrejtë të një partie politike ose të qeverisë dhe nuk do t'u kërkojë dhe as nuk do t'i këshillojë lexuesit të votojnë për asnjë parti politike të caktuar dhe për asnjë kandidat për poste publike, dhe as për politika të tjera të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me verifikimin e fakteve.

[*Emri i operacionit*] nuk do të lidhë asnjë marrëveshje dhe asnjë partneritet me asnjë parti politike dhe do ta trajtojë çdo konflikt të arsyeshëm interesi ose paragjykim politik të ekspertëve ose të organizatave që ai citon ose përdor.

[*Emri i operacionit*] do t'i paralajmërojë punonjësit që të mos bëjnë deklaratat politike në emër

të këtij operacioni dhe të mos pranojnë dhurata, favore ose shërbime me kushte të favorshme në kushtet e punës që shkojnë përtej normave të zakonshme sociale apo mirësjelljes.

Aneksi 4. Formulari Model sipas Nenit 4.1.A

Ky model ose një format i ngjashëm me të që përmban të gjithë këtë informacion duhet të jetë i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen tuaj të internetit:

A është verifikimi juaj i fakteve pjesë e një organizate më të madhe?	PO/JO
Emri me të cilin jeni regjistruar:	
Shteti në të cilin jeni regjistruar:	
Statusi juridik me të cilin jeni regjistruar:	
Emri i regjistrit:	
Numri i regjistrit:	
Pronësia:	<i>Rendisni emrat e atyre personave ose kompanive që zotërojnë më shumë se 5% të aksioneve dhe përqindjen e aksioneve që zotëron secili person ose secila kompani. Nëse organizata juaj nuk ka pronësi, jepni një shpjegim në këtë hapësirë.</i>

Aneksi 5. Formulari Model i Nenit 4. 1. B

Udhëzime: Si mbikëqyret vendimmarrja brenda organizatës suaj ose organizatës suaj mëmë? A ka një bord personash të besuar (trustees)? A merren vendime nga aksionerët? A keni edhe komisione specifike të ngarkuara për marrjen e vendimeve specifike? Përdorni kolonën e majtë për të renditur emrin dhe detyrën e strukturës drejtuese të cilës i referoheni dhe kolonën e djathtë për të renditur emrat e anëtarëve që i përkasin asaj.

Ky model ose një format i ngjashëm me të që përmban të gjithë këtë informacion duhet të jetë i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen tuaj të internetit:

Struktura drejtuese & detyrat e saj	Emri i plotë i personave të përfshirë në të
<i>d.m.th. Bordi i personave të besuar (trustees): përgjegjës për mbikëqyrjen e operacionit, për miratimin e planeve vjetore, për buxhetin, memorien dhe për llogaritë.</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Emër Mbiemër 1 • Emër Mbiemër 2 • Emër Mbiemër 3 • ...
<i>d.m.th. Bordi Këshillimor Editorial: përgjegjës për analizimin dhe përgjigjen e ankesave të lexuesve për punën tonë.</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Emër Mbiemër 1 • Emër Mbiemër 2 • Emër Mbiemër 3 • ...

Aneksi 6. Formulari Model sipas Nenit 4. 1. C

Ky informacion do t'u vihet në dispozicion vetëm vlerësuesve të jashtëm dhe Organit Drejtues dhe nuk është nevoja të bëhet publik.

Dokumenti që vërteton regjistrimin/statusin juridik:	<i>Ngarko dokumentin ose vendos linkun.</i>
Dokumenti i pronësisë:	<i>Ngarko dokumentin ose vendos linkun.</i>
Dokumenti ku tregohet struktura drejtuese:	<i>Ngarko dokumentin ose vendos linkun.</i>

Aneksi 7. Formulari Model sipas Nenit 4. 2. A

Ky informacion do t'u vihet në dispozicion vetëm vlerësuesve të jashtëm dhe Organit Drejtues dhe nuk ka nevojë të bëhet publik:

Emri i kontribuuesit/klientit	Emri i programit ose natyra e marrëveshjes
<i>Z. Mendoj se gazetaria është e rëndësishme</i>	<i>Donator</i>
<i>Organizatë Ne besojmë te gazetaria cilësore</i>	<i>Grant për gazetarinë investigative</i>
<i>Kompani Kam nevojë për ndihmë për të trajtuar ekosistemin e dezinformimit</i>	<i>Klient për Trajtimin e palëve të treta</i>

Aneksi 8. Formulari Model sipas Nenit 4. 2. B

Ky model ose një format i ngjashëm me të që përmban të gjithë këtë informacion duhet të jetë i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen tuaj të internetit:

Të ardhurat tuaja vjetore për vitin e fundit të mbyllur:	
Burimet e të ardhurave që kontribuojnë mbi 5 % të të ardhurave totale vjetore	
Burime të tjera përkatëse të të ardhurave siç kuptohet në nenin 4.2.B:	

Aneksi 9. Formulari Model sipas Nenit 4.2. D

Ky model ose një format i ngjashëm me të që përmban të gjithë këtë informacion duhet të jetë i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen tuaj të internetit:

Emri i organizatës partnere	Përshkrimi i aktiviteteve

Aneksi 10. Formulari Model sipas Nenit 5. 4

Për çdo vend të përfaqësuar nga një anëtar i mundshëm, duhet të ketë:

- të paktën tre vlerësues të jashtëm në rast se anëtarët potencialë nga i njëjti vend, që aplikojnë në të njëjtin vit, janë 3 ose më pak (shih paragrafin 1)
- të paktën katër vlerësues të jashtëm nëse anëtarët potencialë nga i njëjti vend, që aplikojnë në të njëjtin vit, janë më shumë se 3 dhe më pak se 7 (shih paragrafin 2)

Paragrafi 1

Një trupë prej 3 vlerësuesish mund të vlerësojë 1 organizatë çdo 90 ditë. Duke marrë parasysh se mund të ketë edhe Ankesa, që mund të zgjasin 30 ditë, 3 vlerësues që punojnë pa ndërprerje ka të ngjarë të analizojnë, nëse është e nevojshme, deri në 3 organizata në vit.

Për t'u siguruar që e njëjta organizatë të mos vlerësohet nga e njëjta dyshe vlerësuesish për dy aplikime radhazi, vendoset sistemi i mëposhtëm i rotacionit:

(E njëjta organizatë që aplikon)

Aplikimi 1: AB

Aplikimi 2: AC

Aplikimi 3: BC

Pas 3 aplikimeve nga e njëjta organizatë, sistemi i rotacionit fillon nga fillimi.

Paragrafi 2

Një trupë prej 4 vlerësuesish mund të vlerësojë 2 organizata çdo 90 ditë. Duke pasur parasysh se mund të ketë edhe Ankesa, që mund të zgjasin 30 ditë, 4 vlerësues që punojnë pa ndërprerje ka të ngjarë të analizojnë, nëse është e nevojshme, deri në 6 organizata në vit.

Për t'u siguruar që e njëjta organizatë të mos vlerësohet nga e njëjta dyshe vlerësuesish për dy aplikime radhazi, vendoset sistemi i mëposhtëm i rotacionit:

(E njëjta organizatë)

Aplikimi 1: AB

Aplikimi 2: CD

Aplikimi 3: AC

Aplikimi 4: BD

Aplikimi 5: AD

Aplikimi 6: BC

Pas 6 aplikimesh nga e njëjta organizatë, sistemi i rotacionit fillon nga fillimi.

Aneksi 11. Formulari Model sipas Nenit 6

Emri:	
Mbiemri:	
Adresa e kontaktit përmes e-mailit:	
Anëtari i organizatës i EFCSN-së objekt i ankesës:	
Specifikoni se kur ka ndodhur mospërbushja e kërkesave të Kodit Evropian të Standardeve:	ditë/muaji/viti
Rendisni kërkesën/kërkesat specifike të Kodit Evropian të Standardeve që nuk ka përbushur organizata:	
Specifikoni arsyet pse mendoni se nuk janë përbushur kërkesa/kërkesat specifike:	
Paraqisni të gjitha linqet, dokumentet, materialet etj. që tregojnë se organizata që është objekti i ankesës nuk ka përbushur kërkesën/kërkesat e Kodit Evropian të Standardeve:	
A jeni përpjekur ta kontaktoni organizatën anëtare të EFCSN-së që është objekt i ankesës?	PO/JO
Paraqisni të gjitha materialet dhe informacionet përkatëse për të vërtetuar përpjekjen tuaj për ta kontaktuar atë	
A keni marrë përgjigje nga organizata anëtare e EFCSN që është objekt i ankesës?	PO/JO
A keni marrë përgjigje nga organizata anëtare e EFCSN-së që është objekt i ankesës?	PO/JO
Nëse po, pse nuk ishte e mjaftueshme ajo përgjigje për ankesën tuaj?	